



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR SOCIAL WELFARE

**Raport vjetor mbi zbatimin
e Planit të Veprimit për
Parandalimin dhe Eliminimin
e Punës së Fëmijëve**

2012

Raporti përfshin arritjet e institucioneve të nivelit qendror drejt përbushjes së rezultateve të pritura në kuadër të secilit objektiv gjatë vitit 2012, sfidat e evidentuara dhe prioritetet për vitin 2013

**Progresi, sfidat dhe masat e
nevojshme për të siguruar
zbatimin e plotë**

Publikimi i raportit është realizuar nga MPMS

Prishtinë, maj 2013

Shkurtesat

DIPS - Departamenti i Institutit për Politika Sociale

DMS – Departamenti i Mirëqenies Sociale

DKA – Drejtoritë Komunale të Arsimit

ERPMB – Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Mos-regjistrimit dhe Braktisjes

FKPF – Format e Këqija të Punës së Fëmijëve

FRRP – Format e Rrezikshme të Punës

GTP - Grupi Teknik i Punës

IKSHP - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

ILO – Organizata Ndërkombëtare e Punës

IPEC – Programi Ndërkombëtar Për Eliminimin e Punës së Fëmijës

KPM - Kodi Penal për të Mitur

KKPEPF - Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve

KLV – Komiteti Lokal i Veprimit

KDF - Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KPAK - Konventa për Persona me Aftësi të Kufizuara

KPAK - Këshilli i Prindërve dhe Arsimitarëve të Kosovës

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MD - Ministria e Drejtësisë

MFE - Ministria e Ekonomisë dhe Financave

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MPF - Monitorimi i Punës së Fëmijëve

MV - Mbrojtësit e Viktimave

NJDNJ - Njësitë për të Drejtat e Njeriut

NJDNJK – Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Komuna

OJQ - Organizata Joqeveritare

PVPE - Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian

QAP - Qendra për Arsim Profesional

QPS - Qendra për Punë Sociale

PK - Policia e Kosovës

SDF - Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve

SHSK - Shërbimi Sprovues i Kosovës

TEIP – Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës

UA - Udhëzim Administrativ

UNICEF - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

UNKT - Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

ZKM/ZQM - Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta

Pasqyra e lëndës

Hyrje	7
Zbatimi i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve gjatë vitit 2012	9
Progresi drejt arritjes së Objektivit Specifik I	9
Rezultati 1: Është përmirësuar baza e njohurive për punën e fëmijëve	9
Rezultati 2: Puna e fëmijëve është përfshirë në legjislacionin përkatës.....	10
Rezultati 3: Puna e fëmijëve është përfshirë në politikat zhvillimore dhe politikat për reduktimin e varfërisë.....	12
Rezultati 4: Janë funksionalizuar mekanizmat e koordinimit në nivel qendror për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve	12
Rezultati 5: Është përforcuar kapaciteti i institucioneve në nivel qendror dhe lokal për adresimin e punës së fëmijëve	13
Rezultati 6: Partnerët socialë janë aktivë në adresimin e punës së fëmijëve.....	14
Rezultati 7: Është përmirësuar cilësia e arsimit për të gjithë fëmijët	15
Rezultati 8: Shoqëria është ndërgjegjësuar për pasojat negative të punës së fëmijëve	16
Progresi drejt arritjes së Objektivit Specifik II:.....	17
Rezultati 1: Janë eliminuar barrierat e qasjes në arsim dhe janë në dispozicion programet e edukimit joformal	17
Rezultati 2: Janë në dispozicion shërbimet për tërheqjen dhe ri-integrimin afatgjatë të fëmijëve të tërhequr nga Format e Këqija të Punës së Fëmijëve	20
Rezultati 3: Janë funksionale programet për fuqizimin ekonomik të familjeve dhe fëmijëve dhe programet e asistencës së kushtëzuar	21
Rezultati 4: Sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve përsëritet në të gjithë Kosovën	21
Përmbledhje	23

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar të angazhohet në parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, përmes Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2004 ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ILO-së, për implementimin e Programit Ndërkombëtar të ILO-s për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) në Kosovë. Që nga viti 2004, Qeveria e Republikës së Kosovës ka dëshmuar zotimin e saj për adresimin e çështjes së punës së fëmijëve përmes intervenimeve në fushën e legjislacionit, ngritjes së kapacitetit të institucioneve relevante në nivel qendror dhe në nivel komunal, si dhe duke mbështetur nisma të ndryshme për parandalimin e fëmijëve të rrezikuar dhe tërheqjen e fëmijëve të përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve.

Puna e fëmijëve në Kosovë ka shkaqe të shumëfishta dhe është e lidhur ngushtë me gjendjen ekonomike, varfërinë, mbrojtjen sociale, me funksionimin e tregut të punës, rritjen e popullsisë dhe lëvizjet migruese, faktorët kulturorë apo qëndrimet personale, pa përmendur këtu pasojat e konfliktit të armatosur të vitit 1999. Puna e fëmijëve është gjithashtu një pengesë për zhvillimin njerëzor në Kosovë dhe si e tillë nuk mund të trajtohet e izoluar nga konteksti i gjerë në të cilin ndodh.

Qasjet gjithëpërfshirëse për të luftuar punën e fëmijëve kanë të bëjnë, me:

- **Zhvillimin ekonomik** për të rritur të ardhurat e familjeve dhe standardin jetësor: duke mbështetur rritjen dhe shpërndarjen e burimeve në makro-nivel, si dhe duke mbështetur përpjekjet e familjeve nevojtare për të krijuar të ardhura në mikro-nivel;
- **Arsimin** kualitativ, gjithëpërfshirës, pa pagesë dhe i detyrueshëm për të shtuar kapitalin njerëzor. Përfitimi personal i arsimit, përfshin: a) rritjen e shanseve për të gjetur një punësim me rrogë dhe/ose rritje në rrogë, dhe b) lëvizshmëri më të madhe ekonomike e sociale për të shpëtuar nga kurthi i varfërisë. Përfitimet shoqërore përfshijnë planifikim familjar, pjesëmarrje më efektive politike, shtrirje të nivelit të njohurive (në përmirësimin e kujdesit shëndetësor personal e të familjes, mirëqenies e të drejtave të njeriut), një forcë pune më të aftësuar dhe kualifikuar që mund të shpjerë drejt një ekonomie më konkurruese;
- **Zbatimin e ligjeve kundër punës së fëmijëve**, ligjeve për arsimin e detyrueshëm, si dhe të ligjeve që në mënyrë indirekte synojnë fëmijët në konflikt me ligjin (me ndjekje penale dhe ndëshkim efektiv të kriminelëve);
- **Ndryshimin e qëndrimit të qytetarëve** ndaj fëmijëve, më saktësisht, ndryshim pozitiv të qëndrimit të fëmijëve, familjeve, punëdhënësve, klientëve dhe institucioneve ndaj eliminimit të punës së fëmijëve;

- **Shërbimet dhe ndihmën sociale** — për të ndihmuar familjet të mbijetojnë krizat, si: sëmundjet, humbjen e shtëpisë apo strehimit, dhe për të mbështetur kërkesën për arsim (fjala vjen mbështetje e kushtëzuar me të holla që lidh mirëqenien e familjes me prezencën e fëmijës në shkollë).

Me qëllim që t'i japë më shumë përmbytje, qartësi dhe koherencë përpjekjeve të Qeverisë kundër punës së fëmijëve, në muajin maj të vitit 2009, Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF) ka iniciuar procesin për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e FKPF-së.

Në tetor të vitit 2011, Qeveria e Kosovës aprovon Strategjinë për Parandalimin dhe Eliminimin e FKPF-së 2011-2016 dhe Planin e Veprimit 2011-2013. Strategjia mbulon një periudhë kohore gjashtëvjeçare (2011-2016) dhe ofron një kornizë për përcaktimin e prioritetëve, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë të interesuar për të luftuar punën e fëmijëve, përfshirë organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, si dhe partnerët e tjerë, përfshirë dhe vetë fëmijët.

Si pjesë e planifikimit të zbatimit të Strategjisë, Plani i Veprimit mbulon një periudhë trevjeçare (2011-2013) duke caktuar objektivat e ndërmjetme (objektivat specifike), që do të rishikohen më pas, duke pasur parasysh objektivin e përgjithshëm shtatëvjeçar. Raporti në vijim përmban arritjet e institucioneve të nivelit qendror drejt përmbushjes së rezultateve të pritura në kuadër të secilit objektiv, sfidat e evidentuara dhe prioritetet për vitin 2013.

ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE GJATË VITIT 2012

Qëllimi kryesor i Planit të Veprimit (2011-2013) është të përmirësojë performancën e institucioneve relevante, të përmirësojë bazën e të dhënave mbi punën e fëmijëve, të provojë ndërhyrje të drejtpërdrejta për të tërhequr dhe rehabilituar fëmijët e përfshirë në FKPF dhe të dokumentojë praktikatat e mira për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, si një bazë për planifikimin e fazës së dytë të Planit të Veprimit (2014-2016), që do të përfshijë ndërhyrje për zhdukjen e të gjitha formave më të këqija të punës së fëmijëve.

Ky raport vjetor është hartuar nga Grupi Punues për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve, me mbështetje të ILO-IPEC. Raporti është aprovuar nga KKPEPF-ja dhe përmban arritjet drejt përbushjes së rezultateve të pritura në kuadër të secilit objektiv, sfidat e evidentuara dhe prioritetet për vitin 2013 në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara me plan të veprimit për periudhën 2011-2013.

Progresi drejt arritjes së objektivit specifik I

Krijimi i një mjedisi të favorshëm për parandalimin e punës së fëmijëve

Rezultati 1:

Është përmirësuar baza e njohurive për punën e fëmijëve

Të dhënat empirike për shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve, si edhe analizat e tjera mbi lidhjen që ka puna e fëmijëve me dimensione të tjera të zhvillimit, bëjnë të mundur që të merren vendime të informuara mbi punën e fëmijëve dhe të zgjerohet platforma për eliminimin e saj. Mbi këtë bazë, në kuadër të PV-së është planifikuar realizimi i një hulumtimi statistikor mbi punën e fëmijëve në shkallë vendi, për të:

- a) njohur më hollësisht shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve;
- b) përcaktuar një bazë për vlerësimin dhe planifikimin e masave shtesë si pjesë e fazës së dytë të Planit të Veprimit.

Gjatë vitit 2012, MPMS-ja ka zhvilluar disa takime me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), por në mungesë të fondeve ky hulumtim nuk është realizuar ende. Për vitin 2013, MPMS-ja ka ndarë një buxhet të konsiderueshëm për realizimin e hulumtimit, ndërsa ILO-IPEC ka ofruar mbështetjen profesionale të Zyrës së Statistikave për punën e fëmijëve në selinë qendrore të IPEC në Gjenevë. Realizimi i hulumtimit pritet të fillojë së shpejti, ndërsa rezultatet përfundimtare pritet të jenë në dispozicion në vitin 2014.

Një prioritet tjetër i MPMS-së mbetet vendosja dhe funksionalizimi i bazës së të dhënave që do të mbledh të dhënat nga sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve në nivel lokal, për të qenë në gjendje që:

- a) të ofrojë të dhëna për situatën dhe tendencat e përfshirjes së fëmijëve në format më të këqija të punës;
- b) të pasqyrojë profilin e fëmijëve të përfshirë në format më të këqija të punës;
- c) shërbimet e ofruara dhe shërbimet e domosdoshme në mungesë për tërheqjen e fëmijëve nga FKPF-ja;
- d) të analizojë shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve duke nënvizuar lidhjen e saj me problemet e zhvillimit.

Ngecjet e Komiteteve Lokale për MPF-në për evidentimin e të dhënave në komuna, kanë ndikuar në shtyrjen e vendosjes së bazës së të dhënave në MPMS, si dhe në mungesën e raporteve vjetore të MPMS-së për punën e fëmijëve. Angazhimi i MPMS-IPS në konsolidimin e KLV-ve dhe mobilizimin e tyre për evidentimin e rasteve të fëmijëve në punë është i vazhdueshëm¹.

Prioritetet për vitin 2013

- Realizimi i hulumtimit për punën e fëmijëve në nivel vendi;
- Angazhimi i mëtejme në konsolidimin e KLV-ve dhe mobilizimin e tyre për evidentimin e rasteve të fëmijëve në punë.

Rezultati 2:

Puna e fëmijëve është përfshirë në legjislacionin përkatës

Në fund të vitit 2010 Zyra Ndërkombëtare e Punës - Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC) në një proces konsultativ me institucionet relevante ka realizuar një vlerësim të legjislacionit dhe politikave aktuale në fushën e punës së fëmijëve dhe punësimit të të rinjve, prandaj MPMS-ja e ka konsideruar këtë aktivitet si të përfunduar. Vlerësimi në fjalë ka evidentuar edhe boshllëqet në zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe politikave që adresojnë punën e fëmijëve dhe punësimin e të rinjve. Ky raport i vlerësimit është realizuar në bashkëpunim me

¹ Për më tepër në lidhje me progresin drejt konsolidimit të KLV-ve, shih Rezultati 4, Objektivi specifik II, fq. 10,11

përfaqësues të institucioneve dhe organizatave relevante (institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit dhe politikave përkatëse në nivel qendror dhe lokal, Komitetin Kosovar për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, OJQ-të, agjencitë e OKB-së, etj.) dhe përmban edhe rekomandimet për ndërlidhjen sa më efektive të politikave dhe veprimeve për luftimin e punës së fëmijëve me politikat/programet e punësimit të të rinjve dhe rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit në zbatim².

Progres i konsiderueshëm gjatë vitit 2012 është shënuar në ndërmarrjen e iniciativave ligjore për të siguruar përputhshmërinë me konventat relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga puna, përfshirë nxjerrjen e udhëzimeve administrative të MPMS-së për zbatimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit të Ndihmës Sociale, rishikimin e UA mbi Format e Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë (UA FRrPF), nxjerrjen e 19 udhëzimeve administrative të MASHT që dalin nga Ligji i arsimit parauniversitar dhe harmonizimin e legjislacionit në fushën e bujqësisë për të siguruar përputhshmërinë me Konventën 184 të ILO-së mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Bujqësi dhe me UA për format e rrezikshme të punës së fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe janë zbatuar edhe objektiva të ndryshme të strategjisë për të drejtat e fëmijëve në komponentin e shëndetësisë. IKSHPK-ja në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, organizon trajnime për ngritjen e vetëdijes së punonjësve të shkollave dhe atyre që punojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, rreth kujdesit primar dhe parandalim të abuzimit të fëmijëve. Fatkeqësisht jo të gjitha shkollat kanë të integruar shërbimet shëndetësore. Lidhur me vetëdijesimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas mbi rreziqet shëndetësore të kontaminimit me plumb (Pb) për komunitetet e ekspozuara në Mitrovicë janë realizuar aktivitete që ndikojnë në parandalimin e ekspozimit. Raporti vlerësues mbi shkallën e kontaminimit 2012 është përfunduar. Integrimi i komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në sistemin shëndetësor është përmirësuar përmes ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve, megjithatë specifika e problematikës së parandalimit, mostrimit, trajtimit dhe përcjellës së nivelit të Pb në gjak duhet të vazhdojë edhe në vitin 2013.

Gjatë vitit 2012 nga institucionet shëndetësore janë ofruar shërbime shëndetësore për fëmijët dhe familjet, përfshirë edhe fëmijët e lënduar në punë të rrezikshme, por si sfidë mbetet evidentimi, raportimi, këshillimi dhe referimi i këtyre rasteve.

Prioritetet për vitin 2013

- Aprovimi dhe hyrja në fuqi e versionit të rishikuar të UA për FRRPF-në, MPMS;
- Adresimi përkatës i formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në bujqësi në kuadër të të gjitha akteve nënligjore që dalin nga ligjet në fushën e bujqësisë, MBPZHR;
- Adresimi përkatës i punës së fëmijëve gjatë rishikimit të Ligjit të Punës, MPMS;
- Adresimi përkatës i punës së fëmijëve në kuadër të Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve, MPMS;

² Raport mbi analizën e legjislacionit dhe politikave (planeve të veprimit dhe strategjive) mbi punën e fëmijëve dhe punësimin e të rinjve në Kosovë, ILO-IPEC, 2010

- Sigurimi i statistikave të ndara për shërbimet shëndetësore të ofruara për fëmijët e përfshirë format më të këqija të punës, MSH.

Rezultati 3:

Puna e fëmijëve është përfshirë në politikat zhvillimore dhe politikat për reduktimin e varfërisë

Një aspekt thelbësor i Strategjisë për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve është sigurimi se strategjitë zhvillimore dhe kundër varfërisë janë hartuar dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të kenë ndikim pozitiv në luftimin e punës së fëmijëve. Këto strategji përfshijnë sidomos ato që promovojnë zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, që nxisin qasjen ndaj punës dhe punësimit të denjë. Në raportin e PV-së për vitin 2012 nuk është raportuar ndonjë progres në këtë drejtim.

Prioritetet për vitin 2013

- Adresimi i punës së fëmijëve në bujqësi në kuadër të politikave që promovojnë zhvillimin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe në politikat që promovojnë punësimin.

Rezultati 4:

Janë funksionalizuar mekanizmat e koordinimit në nivel qendror për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve

Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve është përtërirë me Vendimin 04/37 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në fund të vitit 2011, Komiteti ka hartuar dhe aprovuar Rregulloren e Punës dhe ka përtërirë Grupin Punues për Rishikimin e listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve dhe Grupin Punues për Monitorimin dhe Raportimin mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër punës së fëmijëve. Të dyja grupet janë funksionale dhe nën mbështetje teknike të ILO-IPEC.

Megjithatë, gjatë vitit 2012 Komiteti nuk ka arritur të funksionojë plotësisht sipas rregullores së përcaktuar. Fuqizimi i mëtejshëm i Komitetit si një trupë koordinuese dhe këshilluese për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë, është një parakusht bazë për një qasje të koordinuar për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit. Raportimi i rregullt tek Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve nga ana e KKPEPF-së do të sigurojë një koordinim të nivelit të lartë ndërmnistror dhe do të garantojë që aktivitetet për punën e fëmijëve kanë një mbështetje më të madhe dhe serioze.

Prioritetet për vitin 2013

- Funkcionalizimi i plotë i Komitetit;
- Shkëmbimi i përvojave me mekanizmat e ngjashëm ndërinstitucional për adresimin e punës së fëmijëve në vendet e regjionit.

Rezultati 5:

Është përforcuar kapaciteti i institucioneve në nivel qendror dhe lokal për adresimin e punës së fëmijëve

Zhvillimi i kapaciteteve është përqendruar në fuqizimin e institucioneve relevante për zbatimin e planit të veprimit. Në këtë kontekst, MPMS-ja me mbështetje të KE-së ka përfunduar zhvillimin e standardeve minimale për shërbime sociale për pesë kategori të grupeve të marginalizuara, përfshirë fëmijët në punë, ndërsa Shërbimi Sprovues i Kosovës ka organizuar trajnime për të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin për zyrtarët e shërbimit sprovues.

ILO-IPEC gjatë kësaj periudhe është angazhuar, në:

- a) fuqizimin e mëtejme të Zyrtares për Punë të Fëmijëve në MPMS, përmes monitorimit të drejtpërdrejtë në përmbushjen e obligimeve;
- b) zhvillimin e kapaciteteve të Njësive për të Drejtat e Njeriut në ministritë e linjës dhe në komuna, përmes punëtorive mbi punën e fëmijëve dhe mbështetjes në zbatimin e iniciativave të ndryshme për adresimin e punës së fëmijëve nga NJDNJ-të e MBPZHR-së, MAPL-së dhe MASHT-it;
- c) trajnimin e zyrtarëve policor të policisë në bashkësi;
- d) trajnimin e inspektorëve të punës;
- e) ngritjen e kapacitetit të drejtorive komunale të bujqësisë, përmes punëtorive me zyrtarët e shërbimeve këshillimore dhe me drejtorët e DKBPZHR-së, si dhe
- f) ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për rini.

Personeli i përgatitur dhe i motivuar në shkallën e duhur është i domosdoshëm për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe iniciuar aktivitete dhe projekte kundër punës së fëmijëve, prandaj zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve apo ngritja e tyre aty ku nuk ekzistojnë do të ndihmojë për të fuqizuar reagimin ndaj punës së fëmijëve.

Prioritetet për vitin 2013

- Ngritja e kapacitetit në Drejtoratet Komunale të Shëndetësisë mbi rolin e punëtorëve shëndetësor në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijëve, MSH;

- Ngritja e kapaciteteve profesionale te ofruesit e shërbimeve sociale në implementimin e standardeve minimale të kujdesit për fëmijët në punët e rrezikshme, MPMS;
- Ngritja e kapaciteteve në institucionet arsimore në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijët, MASHT;
- Fuqizimi i rolit të inspektorëve të punës në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijëve, TEIP;

Rezultati 6:

Partnerët socialë janë aktivë në adresimin e punës së fëmijëve

Kapaciteti i partnerëve social (përfaqësuesve të punëdhënësve dhe të punëtorëve) mbi funksionin e tyre në adresimin e punës së fëmijëve, përfshirë funksionin e tyre në kuadër të KES-it, është ngritur përmes punëtorive të shumta të organizuara nga ILO-IPEC. Në kuadër të draft Marrëveshjes Kolektive janë reflektuar edhe çështjet që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve dhe rolin e partnerëve social në këtë drejtim.

Bazuar në konsultime të shumta me organizatat e punëdhënësve dhe punëdhënësit individual, ILO-IPEC në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës ka përgatitur dhe botuar broshurën “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?”. Bazuar në këtë broshurë OEK-u me mbështetje të ILO-IPEC ka realizuar disa iniciativa për sensibilizimin e punëdhënësve mbi punën e fëmijëve dhe rolin e tyre në adresimin e punës së fëmijëve, me fokus të veçantë në sektorin e ndërtimitarisë dhe të bujqësisë ku vlerësohet se puna e fëmijëve është prezente në zinxhirin e furnizimit. OEK-u në kuadër të kontratave që ka me anëtarët e saj, në vitin 2012 ka përfshirë një klauzolë me të cilën njofton punëdhënësit me rolin e tyre (jo obligativ por të rëndësishëm) në zbatimin e katër parimeve fundamentale të ONP-së (përfshirë adresimin e punës së fëmijëve) dhe parimeve të Global Compact të Kombeve të Bashkuara.

Bazuar në konsultime të shumta me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ILO-IPEC ka përgatitur dhe botuar broshurën “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë organizatat e punëtorëve”. Gjatë periudhës 2011-2012, SBASHK-u me përkrahje të ILO-IPEC ka realizuar disa iniciativa me qëllim të mobilizimit të shkollave për adresimin e punës së fëmijëve përmes shoqatave të SBASHK-ut në shkolla.

Prioritetet për vitin 2013

- Aprovimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive;
- Mobilizimi i mëtejshëm i punëdhënësve në:
 - përfshirjen e punës së fëmijëve në kodet e tyre të etikës, si për aktivitetet e tyre, ashtu edhe për qasje në zinxhirin furnizues (sidomos kur në sektorët e tyre ka nën-kontraktues në ekonominë joformale);

- pjesëmarrjen financiare në aktivitete sociale që shënjestrojnë eliminimin e punës së fëmijëve;
- ofrimin e mundësive të punësimit të familjeve në nevojë;
- Mobilizimi i potencialit të sindikatave për:
 - të kontribuar në adresimin e punës së fëmijëve përmes identifikimit dhe denoncimit të punës së fëmijëve në nivel lokal;
 - Dokumentimin e rasteve konkrete dhe evidentimit të pasojave të punës së fëmijëve;
 - Sensibilizimit të komunitetit për rëndësinë e arsimit të fëmijëve, mbrojtjes së fëmijëve nga rreziqet dhe parandalimin e përfshirjes së tyre në punë.

Rezultati 7:

Cilësia e arsimit është përmirësuar për të gjithë fëmijët

Përpjekja për të siguruar arsim cilësor për të gjithë fëmijët është bazë e të gjitha përpjekjeve për eliminimin e punës së fëmijëve. Gjatë vitit 2012, MASHT-i ka vazhduar jetësimin e nismave të rëndësishme në rrafshin e dokumenteve kryesore ligjore, strategjike e kurrikulare. Implementimi i kornizës së re kurrikulare, përpjekjet e vazhduara për konsolidimin e vlerësimit të jashtëm të nxënësve, përfundimi i investimeve kapitale të filluara para disa vitesh, vazhdimi i furnizimit të fëmijëve të arsimit të obliguar me tekste shkollore, funksionalizimi i sistemit për mbledhjen e menaxhimin e informatave arsimore e të tjera, ngritja e kapacitetit të personelit menaxherial dhe mësimor në shkolla, janë masat kryesore të MASHT-it drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit fillor dhe të mesëm. Vend të rëndësishëm në rritjen e cilësisë zë edhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve, përfshirë rikualifikimet, trajnimet dhe licencimin e tyre. Po aq të vlefshme janë edhe punëtoritë dhe aktivitetet e ndryshme jashtëshkollore, që lidhen me parandalimin e dukurive negative në shkolla, parandalimin e dhunës, trafikimit, punëve të rrezikshme për fëmijë, narkomanisë, etj.

Prioritetet për vitin 2013

- Të shtohen aktivitetet ekstrakurrikulare në shkolla (promovimi i listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve, diskutime, aktivitete artistike, etj.);
- Të zbatohen në shkolla materialet didaktike (të miratuara nga MASHT) dedikuar parandalimit të punës së fëmijëve;
- Të inkurajohen shkollat në planifikimin e temës kundër punëve të rrezikshme për fëmijë, si lëndë zgjedhore.

Rezultati 8:

Shoqëria është ndërgjegjësuar për pasojat negative të punës së fëmijëve

MBPZHR-ja në bashkëpunim me drejtoratet komunale për bujqësi, me mbështetje të ILO-IPEC është angazhuar në vetëdijësimin e fermerëve përfitues të subvencioneve dhe granteve të MBPZHR-së mbi format e rrezikshme të punës së fëmijëve në sektorin e bujqësisë, rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në këto aktivitete dhe shkaqet e përfshirjes së fëmijëve në aktivitete të rrezikshme në bujqësi. Në vazhdimësi të fushatës sensibilizuese me fermerë, MBPZHR-ja me mbështetje të ILO-IPEC organizoi një konferencë pune për të diskutuar gjetjet nga takimet me fermerë rreth situatës së punës së fëmijëve në bujqësi dhe pylltari, për të planifikuar masat e nevojshme për adresimin e PRRF-së në bujqësi dhe për të vendosur një platformë të përbashkët të MBPZHR-së me autoritetet komunale përkatëse, organizatat e punëdhënësve, prodhuesit dhe përpunuesit e ushqimit, shoqatat e fermerëve, si dhe partnerët e tjerë për adresimin e punës së fëmijëve.

Fushata Kundër Trafikimit 2012, u fokusua në eksploatimin e fëmijëve për qëllime seksuale, për punë dhe lypje. Qëllim i fushatës ishte rritja e vetëdijes së përgjithshme, por veçmas e fëmijëve, prindërve dhe mësimitdhënësve lidhur me rrezikun e trafikimit.

ILO-IPEC ka financuar botimin e pakos edukative “Mbështetja e të Drejtave të Fëmijëve përmes Edukimit, Artit dhe Mediave (SCREAM)” në gjuhën shqipe dhe në bashkëpunim me MKRS-në ka organizuar punëtori me përfaqësues të qendrave rinore dhe OJQ-ve aktive me programe për të rinj dhe fëmijë, me qëllim të ngritjes së kapacitetit të tyre për shfrytëzimin e SCREAM dhe identifikimin e mundësive për shfrytëzim të kësaj pakoje edukative në aktivitetet e përditshme.

Mobilizimi social është thelbësor për të ndërtuar një bazë të rëndësishme shoqërore për çrrënjosjen e të gjitha formave të këqija të punës së fëmijëve, prandaj angazhimet në këtë drejtim mbeten prioritet edhe për vitin 2013.

Prioritetet për vitin 2013

- Sensibilizimi i parlamentarëve;
- Mobilizimi i personaliteteve të njohura të cilët mund të influencojnë opinionin publik;
- Sensibilizimi dhe mobilizimi i mjeteve të informimit publik;
- Ndërgjegjësimi i mëtejshëm i fermerëve mbi punët e rrezikshme të fëmijëve në bujqësi.

Progresi drejt arritjes së objektivit specifik II

Zbatimi i ndërhyrjeve të menjëhershme për parandalimin e përfshirjes së fëmijëve të rrezikuar dhe tërheqjen e fëmijëve të përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve

Rezultati 1:

Janë eliminuar barrierat e qasjes në arsim dhe janë në dispozicion programet e edukimit joformal

Në vazhdimësinë e aktiviteteve për zbatimin e legjislacionit vendor (Ligjit të arsimit parauniversitar dhe akteve nënligjore), Planit Strategjik të Arsimit 2011-2016 dhe Planit Kombëtar të Veprimit kundër braktisjes së shkollimit 2009-2014 (ku trajtohet problemi i braktisjes së shkollës nga nxënësit pa dallim gjinie³), Planit të Veprimit për Parandalimin e Punës së Fëmijëve, MASHT-i gjatë periudhës 2011-2012 ka realizuar një varg aktiviteteve:

- MASHT-i çdo vit i jep tekstet falas për të gjithë nxënësit e arsimit të obliguar (1-9), gjë që ndikon në parandalim të braktisjes;
- MASHT-i ka hartuar dhe shpërndarë në drejtoritë komunale të arsimit UA Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar;
- Ka shumë aktivitete të planit që janë kompetencë e komunave dhe shkollave dhe të cilat zbatohen në vazhdimësi (transporti i nx. , listat e nx. të klasave të para, grumbullimi i të dhënave për braktisje, etj.);
- Aktivitetet e MASHT-it që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve dhe shkollave për menaxhimin e të dhënave në arsim, janë duke ndodhur në vazhdimësi;
- MASHT-i dhe GIZ-i kanë vazhduar me kurse kompensuese të arsimit joformal, ashtu që nëpërmjet arsimit joformal, nxënësit braktisës mund të ri-integrohen në sistem të rregullt.

MASHT-i me ndihmën e UNICEF-it dhe donatorëve të tjerë, po realizon projektin “Forcimi i komuniteteve RAE në Fushë Kosovë”, i cili ka për qëllim të përmirësojë vijueshmërinë e fëmijëve RAE në arsim dhe performancën e tyre në mësimnxënie. Monitorimi i ndikimit të këtyre masave në tërheqjen dhe ri-integrimin afatgjatë të fëmijëve të përfshirë në punë, do të kontribuonte në zhvillimin e një modeli të intervenimit për fëmijët e komuniteteve RAE.

Si rezultat i veprimeve të deritanishme konsiderohet edhe ulja e shifrave të braktisjes prej vitit në vit.

3 Në nivel të arsimit 1-9 dhe 10-13 e kemi më të madhe braktisjen nga djemtë. (Burim informacioni SMIA/MASHT)

Numri i nxënësve që e kanë lënë shkollën në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (Klasat 1-9): ndarja sipas gjinisë dhe vitit shkollor

Viti shkollor	Total	Kanë lënë shkollën	Meshkuj	Femra
2002/03	340 257	5682 (1.67%)	3075 (54%)	2607 (46%)
2003/04	354 918	5703 (1.61%)	2654 (47%)	3049 (53%)
2004/05	355339	4141 (1.17%)	1932 (47%)	2209 (53%)
2006/07	300703	2431 (0.81%)	948 (38 %)	1483 (61%)
2007/08	322107	2250 (0.69%)	1080 (48%)	1170 (52%)
2008/09	316910	2102 (0.66%)	1109 (52%)	993 (47%)
2009/2010	311198	1920 (0.61%)	942 (49 %)	978 (50 %)
2010/2011	287049	1485 (0.51%)	767 (52%)	718 (48%)
2011/2012	288378	1339 (0.46%)	695 (51%)	644 (48%)

Numri i nxënësve që e kanë lënë shkollën në arsimin e mesëm të lartë: ndarja sipas gjinisë dhe vitit shkollor.

Viti shkollor	Total	Kanë lënë shkollën	Meshkuj	Femra
2002/03	66968	1554 (2.32%)	992 (64%)	562 (36%)
2003/04	68361	2433 (3.56%)	1570 (65%)	863 (35%)
2004/05	68976	1428 (2.07%)	982 (67%)	446 (33%)
2006/07	84297	2425 (2.9%)	1604 (66%)	821 (33%)
2007/08	90180	3321 (3.7%)	2429 (73%)	892 (26%)
2008/09	96115	3246 (3.4%)	2302 (70%)	944 (29%)
2009/10	104048	3208(3.08 %)	2212 (68 %)	996 (26%)
2010/2011	106357	3135 (2.9%)	2259 (72%)	876 (38%)
2011/2012	104.268	2642 (2.5%)	1877 (71%)	765 (25.54%)

Të dhënat e mësipërme tregojnë një rënie të numrit të fëmijëve që braktisin shkollën, edhe pse edhe shifrat ekzistuese janë për brengosje. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se shumë nga fëmijët që braktisin shkollën punojnë.

Në kuadër të angazhimeve për zhvillimin e profileve të veçanta të AAP-së, gjatë vitit 2012, MASHT-i ka vazhduar hartimin e kurrikulave për profile të ndryshme, furnizimin e shkollave me punëtori e pajisje, ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese e të tjera, që kanë kontribuar për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në këtë nënsektor. Si rezultat mund të veçohet hartimi i standardeve të profesionit dhe kurrikulave për 6 profile të reja të sektorit të bujqësisë, një për qeramikë dhe 21 për sektorin e shëndetësisë, ekonomisë dhe turizmit. MASHT-i ka intensifikuar edhe takimet me MPMS-në, MT-në, OEK-un dhe partnerët e tjerë me qëllim të analizës së tregut të punës, ka rifunksionalizuar nëngrupet sektoriale për AAP-në si dhe ka themeluar wiki-platformën ku janë regjistruar të gjitha shkollat profesionale. Po ashtu është planifikuar që kjo platformë të mundësojë lidhjen me MPMS-në dhe OEK-un dhe qasjen në analizat e tregut të punës dhe të dhënat e bizneseve.

Çështjet e iniciativave për përfshirjen e aspekteve specifike që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve në politikat dhe programet arsimore dhe shqyrtimin e mundësive për përfshirje më të plotë të shqetësimeve që lidhen me punën e fëmijëve në planet dhe programet sektoriale të arsimit janë adresuar nga Njësia për të Drejtat e Njeriut në MASHT, e cila tanimë është edhe pjesë e grupit të ekspertëve për rishikimin e planprogrameve të vjetra dhe zbatimin e Kornizës së Kurrikulumit të Ri të Kosovës dhe kurrikulave bërthamë. Në këtë proces pritet që ndër të tjera të shihet edhe hapësira e nevojshme për temën e punës së fëmijëve, me gjithë hapësirën që e ka në tekstet aktuale.

Asociacioni i Komunave të Kosovës, respektivisht, Kolegjiumi për Arsim dhe Kulturë me mbështetje të ILO-IPEC dhe në bashkëpunim me MASHT-in, organizoi punëtorinë dyditore “Arsimi dhe puna e fëmijëve”. Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues nga MASHT-i, përfaqësues nga Instituti i Politikave Sociale-MPMS, përfaqësues të Drejtorateve Komunale të Arsimit, përfaqësues të DKSHMS-ve, përfaqësues të QPS-ve, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Arsimit (SBASHK), organizatave jo qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare.

Barrierat e qasjes në arsim të vërejtura deri tani dhe të konfirmuara nga diskutimet e zhvilluara në punëtorinë me DKA-të mund të grupohen në:

- a) barriera të qasjes (largësia nga shkolla; pengesat që vijnë si pasojë e problemeve të ndryshme sociale (angazhimi i fëmijëve në punë, martesat e hershme që janë specifike për komunitete RAE);
- b) pengesat që hasin fëmijët që kombinojnë punën dhe shkollën; mungesa e regjistrimit të lindjes; dhuna në shkolla);
- c) shpenzimet (e drejtpërdrejta ose indirekte: uniforma, ushqime; përfitimet e mundshme që mund të humbë familja nëse fëmija braktis shkollë në dobi të punën) dhe
- d) cilësia e shërbimeve arsimore dhe të mirëqenies sociale në funksion të trajtimit me efikasitet të problemit të braktisjes së shkollës si pasojë e involvimit në punë (problemet me zbatim të legjislacionit adekuat, mungesa e bashkëpunimit efikas të strukturave përgjegjëse në nivel komunal; mungesë e trajnimit adekuat dhe materialeve për mësuesit; mungesa e njohurive apo ndërgjegjësimit tek autoritetet shkollore mbi nevojat e fëmijëve që braktisin shkollën dhe atyre që e vijnë mësimin e rregullt).

Masat për adresimin e barrierave në arsim përfshirë mbështetjen e nevojshme për fëmijët që janë në rrezik për të braktisur shkollën, fëmijët që kombinojnë shkollën dhe punën apo për fëmijët që kanë braktisur shkollën mbeten modeste dhe kërkojnë kujdes të shtuar nga ana e të gjitha autoriteteve

relevante komunale. Konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga punëtorja ofrojnë një bazë të mirë për hartimin e një programi pilot për eliminimin e barrierave në arsim. Më tej MASHT-i në koordinim me ILO-IPEC vazhdon me përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve dhe shkollave për rolin e institucioneve arsimore në parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në punë të rënda.

Prioritetet për vitin 2013

- Monitorimi i zbatimit të U.A. Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar;
- Mbështetja e DKA-ve në zhvillimin dhe aplikimin e planeve për eliminimin e barrierave në arsim për fëmijët e përfshirë në punë.

Rezultati 2:

Janë në dispozicion shërbimet për tërheqjen dhe ri-integrimin afatgjatë të fëmijëve të tërhequr nga Format e Këqija të Punës së Fëmijëve

Me iniciativë të MBPZHR-së dhe DKSHMS-ë në Komunën e Rahovecit dhe me mbështetje të ILO-IPEC, OJQ RDSA është duke zbatuar një projekt për pilotimin e një pakoje të shërbimeve elementare për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve të përfshirë në FRRPF në bujqësi, në fshatrat Bratotin dhe Vrajakë të komunës së Rahovecit. Projekti financohet nga FDC (Finnish Development Cooperation) dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet komunale të Komunës së Rahovecit, të cilat kanë siguruar gjithë mbështetjen e nevojshme institucionale. Raporti me arritjet e projektit, mësimet e nxëna dhe vazhdimësinë e nevojshme për adresimin efektiv të punës së rrezikshme të fëmijëve në sektorin e bujqësisë pritet të jetë në dispozicion në fund të projektit (tetor 2013).

Sa i përket pilotimit të intervenimeve për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve në rrugë dhe atyre në konflikt me ligjin nuk është evidentuar ndonjë progres, gjë që e vendos si prioritet për vitin 2013.

Prioritetet për vitin 2013

- Vazhdimi i intervenimeve për eliminimin e punëve të rënda në bujqësi dhe pylltari;
- Pilotimi i masave të nevojshme për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve që punojnë në rrugë dhe atyre që janë në konflikt me ligjin ose shfrytëzimi i rekomandimeve të ILO-IPEC (QMVPT) dhe UNICEF (Terre des Hommes) të dala nga pilotimi i intervenimeve për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve në rrugë dhe atyre në konflikt me ligjin në periudhën 2007-2009, me rastin e përgatitjes së fazës së dytë të planit të veprimit (2014-2016).

Rezultati 3:

Janë funksionale programe për fuqizimin ekonomik të familjeve dhe fëmijëve dhe programe të asistencës së kushtëzuar

Ndërhyrjet e drejtpërdrejta për fuqizimin ekonomik të familjeve dhe fëmijëve do të mundësonin ofrimin e asistencës në rastet specifike të fëmijëve të përfshirë apo në rrezik për t'u përfshirë në format e këqija të punës së fëmijëve. Përkundër rëndësisë së këtyre programeve për adresimin e shkaqeve bazë të problemit: varfëria kronike, cenueshmëria e përgjithshme e familjeve, mungesa e qasjes në arsim dhe luftimin e qëndrimeve kulturore, nuk ka pasur ndonjë iniciativë për pilotimin e efektivitetit dhe eficiencës së tyre në adresimin e punës së fëmijëve.

Prioritetet për vitin 2013

- Përfshirja e shqetësimeve që lidhen me punën e fëmijëve në programet për fuqizim ekonomik (programet për gjenerimin e të hyrave, programet e punësimit, programet për zhvillimin e bujqësisë, etj.);

Rezultati 4:

Sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve përsëritet në të gjithë Kosovën

MPMS-IPS në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe me mbështetjen e ILO-IPEC, gjatë vitit 2011 ka bërë arritje të konsiderueshme në ngritjen dhe përgatitjen e strukturave të Monitorimit të Punës së Fëmijëve në komuna, përmes punëtorive të realizuara me të gjitha KLV-të si dhe përgatitjes dhe botimit të “Udhëzuesit për zhvillimin e procesit të MPF-së në komuna”, në gjuhën shqipe dhe serbe.

Përveç komunikimit të vazhdueshëm me koordinatoret e KLV-ve dhe disa punëtorive të organizuara me koordinatoret, gjatë vitit 2012, MPMS-IPS me mbështetje të ILO-IPEC realizoi edhe punëtori me Komitetet Lokale të Veprimit në të gjitha komunat e Kosovës⁴. Qëllimi i punëtorive ishte diskutimi i zhvillimeve në konsolidimin e MPF-së në komuna, sfidat dhe zgjidhjet e mundshme. Një raport përmbledhës me situatën e përgjithshme të KLV-ve në komuna (problemet e përgjithshme me të cilat ato përballen), rekomandimet për funksionalizimin e KLV-ve dhe prioritetet për vitin 2013 është përgatitur dhe është ndarë me të gjitha KLV-të.

Në vazhdimësi të punëtorive të fundit të organizuara nga MPMS-IPS me KLV-të në komuna dhe mbështetjes së ofruar në kompletimin e procedurave, rregulloreve dhe formave të nevojshme, progres i konsiderueshëm është evidentuar në disa komuna, përfshirë:

⁴ Komunat të cilat nuk iu përgjigjën ftesës për punëtori janë Klokoti, Juniku dhe Ranillugu; në komunat me shumicë serbe punëtoritë nuk janë organizuar pasi që atje ende nuk janë themeluar KLV-të.

- **Gjakovën, Kaçanikun, Hanin e Elezit, Dragashin, Vushtrrinë, Lipjanin dhe Podujevën** ku janë zyrtarizuar procedurat standarde të veprimit, rregullorja e punës së KLV-së dhe forma për evidentimin e rasteve si dhe janë hartuar planet komunale të veprimit për adresimin e PF-së;
- **Rahovecin**, ku janë finalizuar procedurat standarde të veprimit, rregullorja e punës së KLV-së dhe plani i punës për vitin 2013 por ende nuk janë zyrtarizuar;
- **Dardanën**, ku është hartuar dhe miratuar nga Asambleja Komunale plani komunal i veprimit për vitin 2013

Mbështetja dhe mbikëqyrja institucionale e KLV-ve në komuna vazhdon të jetë problem për funksionalizimin e KLV-ve.

Prioritetet për vitin 2013

- Angazhim i mëtejshëm i MPMS-së për institucionalizimin dhe funksionalizimin e plotë të KLV-ve në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe MAPL-në.

PËRMBLEDHJE

Reduktimi i punës së fëmijëve karakterizohet më tepër nga parandalimi i përfshirjes së fëmijëve në punë sesa nga tërheqja e atyre që tanimë punojnë. Ky proces dinamik thekson faktin se **parandalimi** është rruga parimore për eliminimin e qëndrueshëm të punës së fëmijëve. Nisur nga kjo, Strategjia për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në Kosovë, thekson nevojën për vendosjen e kujdeshme të sistemeve parandaluese. Në kuadër të masave parandaluese, përkundër progresit të konsiderueshëm që është shënuar gjatë kësaj periudhe, nevojitet angazhim i shtuar për:

- a) eliminimin e barrierave në arsim dhe krahas kësaj ngritjen e vetëdijes së prindërve që të shohin shkollimin si zgjidhjen më të mirë për fëmijët e tyre;
- b) garantimin e ndihmës sociale për familjet në nevojë ose mbështetjes për gjenerim të të ardhurave për familjet në nevojë.

Duke ditur se ekziston një numër i konsiderueshëm i fëmijëve që tashmë janë të përfshirë në FKPF, Plani i Veprimit parasheh një sërë masash aktive për t'i **larguar dhe rehabilituar** fëmijët që punojnë, apo për t'i larguar nga vendet/situatat e rrezikshme të punës. Këto masa kërkojnë edhe veprime të ndërhyrjes urgjente për situatat kur fëmijët janë të përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve. Duke marrë parasysh faktin se gjatë kësaj periudhe nuk i është kushtuar vëmendje e duhur përcaktimit të një pakoje minimale të shërbimeve si dhe fuqizimit të iniciativave të bazuara në komunitet për përkrahje sa më të mirë të grupeve specifike të fëmijëve që punojnë, ky obligim mbetet prioritet për vitin 2013.

Mbrojtja e punëtorëve të rinj është një shqetësim tjetër i kësaj Strategjie. Shumë fëmijë që e kanë arritur moshën minimale për punësim janë në rrezik dhe duhet të mbrohen nga punët e rrezikshme, përmes fuqizimit të mbikëqyrjes ligjore dhe përmirësimit të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe përmes ngritjes së vetëdijes së të rinjve për masat e sigurisë në punë.

Pakoja legjislative që rregullon qeverisjen lokale hyri në fuqi në qershor të vitit 2008, për të siguruar një bazë ligjore për:

- a. bartjen e kompetencave nga pushteti qendror drejt pushtetit lokal;
- b. krijimin e komunave të reja në përputhje me propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit;
- c. reformimin e administratës lokale.

Në këtë proces të reformimit dhe fuqizimit të administratës lokale, vëmendje e duhur duhet t'i kushtohet edhe përfshirjes adekuate të shqetësimeve që lidhen me punën e fëmijëve.

Objektivi Specifik I			
Krijimi i një mjedisi të favorshëm për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve			
Rezultati i pritshëm 1: Baza e njohurive për punën e fëmijëve është përmirësuar			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
1.1 Realizimi i një studimi mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve	ESK	Buxheti i pjesshëm për këtë aktivitet është zotuar nga MPMS-ja për vitin 2013. Prioritet për 2013 është sigurimi i pjesës tjetër të fondeve dhe realizimi i studimit.	Realizimi i hulumtimit për punën e fëmijëve në nivel vendi.
1.2 Vendosja dhe funksionalizimi i bazës së të dhënave në MPMS-ë për regjistrimin e të dhënave të gjeneruara përmes MPF-së	MPMS	Ky proces varet nga niveli i konsolidimit të KLV-ve prej të cilave duhen siguruar të dhënat e vazhdueshme (shih 4.1 dhe 4.2, Objektivi specifik II).	Inicimi i procesit për vendosjen e bazës së të dhënave.
1.3 Gjenerimi i raporteve të rregullta statistikore mbi FKPF-në nga të dhënat e MPF-së	MPMS	Funksionalizimi i KLV-ve nuk është arritur ende dhe të dhënat vjetore mbi punën e fëmijëve në komuna mbeten të cilësisë së dobët për t'u konsoliduar në një raport shtetëror. Angazhimi i IPS-MPMS në konsolidimin e KLV-ve dhe mobilizimin e tyre për evidentimin e rasteve të fëmijëve në punë është i vazhdueshëm (shih 4.1 dhe 4.2, OS II).	Angazhim i mëtejshëm në konsolidimin e KLV-ve dhe mobilizimin e tyre për evidentimin e rasteve të fëmijëve në punë.
Rezultati i pritshëm 2: Puna e fëmijëve është përfshirë në legjislacionin përkatës			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
2.1 Vlerësimi i bazës ligjore ekzistuese	MPMS	Në fund të vitit 2010 Zyra Ndërkombëtare e Punës - Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC), ka realizuar një vlerësim të legjislacionit dhe politikave aktuale në fushën e punës së	

		<p>fëmijëve dhe punësimit të të rinjëve. Vlerësimi është realizuar duke u bazuar në: a) analizën e ligjeve dhe politikave relevante të Qeverisë së Kosovës për të verifikuar nëse janë në përputhje me Konventat 138 dhe 182 të ONP-së, dhe b) në një proces konsultativ me institucionet relevante për të evidentuar boshllëqet në zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe politikave që adresojnë punën e fëmijëve dhe punësimin e të rinjve.</p> <p>Raporti i vlerësimit është në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.</p>	
<p>2.2 Ndërmarrja e iniciativave ligjore për të siguruar përputhshmërinë me konventat relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga puna</p>	<p>MPMS</p>	<p>UA nr. 1/2012 për sistemimin e punëve të lehta dhe të ndaluara për personat nën moshën 18 vjeçare, sistemon punët e lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe zhvillimin psikofizik të personave 15-18 vjeçar, përkatësisht sistemimin e punëve të ndaluara me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet e veçanta, duke ruajtur shëndetin, sigurinë, moralin dhe zhvillimin psikofizik të të rinjve.</p> <p>Gjatë vitit 2012 komisioni parlamentar ka monitoruar Ligjin e Punës dhe ka hartuar raportin e monitorimit. Gjatë vitit 2013 do të rishikohet Ligji i Punës.</p> <p>MASHT-i ka vazhduar jetësimin e nismave të rëndësishme në rrafshin e dokumenteve kryesore ligjore, strategjike e kurrikulare, përfshirë hartimin e akteve nënligjore që kanë operacionalizuar ligjet bazike</p>	<p>Adresimi përkatës i punës së fëmijëve gjatë rishikimit të Ligjit të Punës.</p>

		arsimore të miratuara gjatë vitit 2011. Në këtë kontekst janë hartuar dhe miratuar 19 udhëzime administrative që dalin nga ligji i arsimit parauniversitar.	
2.3 Rishikimi i UA 17/2008 për të përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e agjencive zbatuese të ligjit.	MPMS	<p>Vendimi nr. 360 i Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 2 dhjetor 2011, në emër të Komitetit themelon GP-në për rishikimin e listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve. Gjatë periudhës dhjetor 2011 - qershor 2012 Grupi Punues, me mbështetje të ILO/IPEC, është takuar tetë herë me qëllim të rishikimit të Listës së FRRPF-së në Kosovë dhe UA 17/2008. Takimi i shtatë i grupit punues është zhvilluar në formë të një punëtorie të zgjeruar me 50 përfaqësues të institucioneve të ndryshme, organizatave të punëdhënësve, punëtorëve dhe shoqërisë civile që në mënyrë direkte apo indirekte kanë të bëjnë me punën e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga puna e rrezikshme. Takimi final i grupit punues është realizuar për përfshirjen e komenteve nga takimi konsultativ dhe finalizimin e rekomandimeve për rishikimin e UA 17/2008. Pas miratimit të Rekomandimeve të GP-së nga Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve, në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të MPMS-së, janë bërë intervenimet përkatëse në UA 17/2008, janë realizuar konsultimet finale për harmonizim të legjislacionit dhe UA është i gatshëm për dorëzim në Qeveri për aprovim.</p>	Aprovimi dhe hyrja në fuqi e versionit të rishikuar të UA për FRRPF-në.

<p>2.4 Rishikimi i Ligjit për Skemën e Asistencës Sociale për shënjestrimin më të mirë të familjeve në nevojë në Kosovë</p>	MPMS	<p>Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, ka hyrë në fuqi më 30.05.2012. MPMS-ja ka punuar intensivisht për hartimin e akteve nënligjore që kanë operacionalizuar Ligjin për SNS-në, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -UA për llogaritjen e të mirave materiale dhe jo materiale si dhe të hyrave të llogaritshme dhe jo të llogaritshme; - UA për procedurat e regjistrimit, certifikimit dhe kërkimit aktiv të punësimit për të papunësuarit që aplikojnë për ndihmë sociale; - UA për procedurat e punës, kriteret dhe metodologjia e ekzaminimit dhe përcaktimit të gjendjes shëndetësore dhe përcaktimi i shkallës së paaftësisë për aplikuesit për SNS-në; - UA për llogaritjen dhe pagesën e shumës mujore të ndihmës sociale; - UA për procedurat e paraqitjes së kërkesës për ndihmë sociale. 	
<p>2.5 Rishikimi i legjislacionit në fushën e bujqësisë për të siguruar përputhshmërinë me Konventën 184 të ILO-s mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Bujqësi</p>	MBPZHR	<p>Legjislacioni i MBPZHR-së është në harmoni me legjislacionin e BE-së. NJDNJ-ja është pjesë e hartimit të legjislacionit të MBPZHR-së.</p>	<p>Adresimi përkatës i formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në bujqësi në kuadër të të gjitha akteve nënligjore që dalin nga ligjet në fushën e bujqësisë.</p> <p>Me risistemimin e inspektoratit bujqësor masat përkatëse për zbatimin e Listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve do të përfshihen në mandatin e këtij institucioni.</p>

Rezultati i pritshëm 3: Puna e fëmijëve është përfshirë në strategjitë zhvillimore dhe strategjitë për reduktimin e varfërisë			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
3.1 Përfshirja e punës së fëmijëve në strategjitë zhvillimore dhe strategjitë me synim uljen e varfërisë	MPMS	Nuk është raportuar ndonjë progres.	Adresimi i punës së fëmijëve në bujqësi në kuadër të politikave që promovojnë zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe në politikat që promovojnë punësimin.
3.2 Zbatimi i komponentit të shëndetësisë në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të DF-në	MSH, MKRS, MASHT, Komunitat	Gjatë vitit 2012 nga institucionet shëndetësore janë ofruar shërbime shëndetësore për fëmijët dhe familjet, përfshirë edhe fëmijët e lënduar në punë të rrezikshme, por si sfida mbetet evidentimi, raportimi, këshillimi dhe referimi i këtyre rasteve. Janë zbatuar objektiva të ndryshme të strategjisë për të drejtat e fëmijëve në komponentin e shëndetësisë. IKSHP-ja në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm organizon trajnime për ngritjen e vetëdijes së punonjësve të shkollave dhe atyre që punojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore rreth kujdesit primar dhe parandalimit të abuzimit të fëmijëve. Fatkeqësisht jo të gjitha shkollat i kanë të integruara shërbimet shëndetësore. Lidhur me vetëdijesimin e komunitetit RAE mbi rreziqet shëndetësore të kontaminimit me plumb (Pb), për komunitetet e ekspozuara në Mitrovicë, janë realizuar aktivitete të cilësuar si të domosdoshme që ndikojnë në parandalimin e ekspozimit. Është përfunduar raporti vlerësues mbi shkallën e kontaminimit 2012.	Sigurimi i statistikave të ndara për shërbimet shëndetësore të ofruara për fëmijët e përfshirë në format më të këqija të punës. Integrimi i komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në sistemin shëndetësor është përmirësuar përmes ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve, megjithatë specifika e problematikës së parandalimit, mostrimit, trajtimit dhe përcjellës së nivelit të Pb në gjak duhet të vazhdojë edhe në vitin 2013.

<p>3.3 Zbatimi i Strategjisë dhe PV-ja kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011, me fokus në komponentin e parandalimit.</p>	<p>Grupi Anti-Trafikim, Komunat</p>	<p>Progresi i shënuar në zbatimin e komponentit të parandalimit në kuadër të PVKTQNJ-së, përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> -11 të mitur (7 VT, 4 VPT) që morën ndihmë dhe shërbime nga QPS-të në partneritet dhe bashkëpunim me Policinë, Mbrojtësit e Viktimave dhe strehimoret; -Të gjitha VT-të regjistrohen në aktivitete arsimore në një mënyrë apo tjetër. Disa kanë vazhduar shkollimin e rregullt dhe disa të tjerë kanë vazhduar përfshirjen arsimore të fëmijëve të pambrojtur dhe fëmijëve viktimë të trafikimit përbrenda strehimores; -Kurset profesionale për fëmijët e pambrojtur dhe fëmijët viktimë të trafikimit janë siguruar në strehimore dhe jashtë (për ECDL, rrobaqepës dhe kosmetologë); -Ekzistojnë 6 zyra në dispozicion, për të intervistuar fëmijët viktimë të trafikimit; -MPMS-ja ka mbikëqyrur cilësinë e ofruesve të shërbimeve për VT-të, me anë të vizitave të monitorimit në QPS-ë, strehimoret dhe mbikëqyrjen me anë të informatave të pranuar në MPMS-ë; -Ka pasur përpjekje për të përmirësuar koordinimin e qeverisjes lokale dhe institucioneve joqeveritare në menaxhimin e rasteve me anë të Task Forcave të organizuara nga TDH-të, si dhe iniciativa individuale siç është ajo e QMVPT-së; MASHT-i në bashkëpunim me shoqatën prind-mësimdhënës ka organizuar 10 punëtori për të drejtat e fëmijëve, në Gjilan, 	
---	-------------------------------------	---	--

		<p>Viti, Klokot, Han i Elezit, Kaçanik dhe Ferizaj. Numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në këtë aktivitet ishte 360. Çështjet që u diskutuan në këto punëtori ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informatat e përgjithshme mbi të drejtat e fëmijëve/të drejtat e njeriut – instrumentet ndërkombëtare; - Mekanizmat e të drejtave të njeriut në Kosovë; - Integrimi i të drejtave të njeriut/ të fëmijëve në sistemin arsimor; dhe - Roli i shkollës në parandalimin e dhunës, trafikimit, drogës, etj. 	
Rezultati i pritshëm 4: Janë funksionalizuar mekanizmat e koordinimit në nivel qendror, për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
4.1 Ngritja e kapacitetit të KKPEPF-së	MPMS	<p>Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve është përtërirë me Vendimin 04/37 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë rast është përditësuar përbërja e Komitetit, roli dhe përgjegjësitë si dhe mënyra e funksionimit të këtij Komiteti. Me mbështetje të ILO-IPEC, Komiteti ka hartuar edhe Rregulloren e Punës të cilën e ka aprovuar në mbledhjen e datës 8 dhjetor 2011 dhe është fuqizuar me 15 dhjetor 2011 përmes Vendimit 373 të Ministrit të MPMS-së. Menjëherë pas përtëritjes, Komiteti është takuar tri herë gjatë vitit 2011 (3 nëntor 2011, 11 nëntor 2011 dhe 8 dhjetor 2011). Gjatë vitit 2012 Komiteti është takuar 2 herë (nga katër takimet e planifikuara).</p>	<p>Funksionalizimi i plotë i Komitetit;</p> <p>Shkëmbimi i përvojave me mekanizmat e ngjashëm ndër-institucional për adresimin e punës së fëmijëve në vendet e regjionit.</p>

<p>4.2 Institucionalizimi dhe fuqizimi i Grupit Teknik Punues mbi MPF-në si dhe grupeve tjera teknike të themeluara nga KKPEPF-ja</p>	<p>MPMS Ministritë e linjës të përfaqësuar në GTP-ë për MPF-në</p>	<p>Me qëllim të fuqizimit të Grupeve Punuese të Komitetit, ZPF-MPMS me mbështetje të ILO-IPEC ka bërë një raport për Komitetin mbi funksionimin dhe performancën e grupeve punuese, përfshirë rekomandimet për funksionalizimin e tyre.</p> <p>Në takimin e datës 3 nëntor 2011 Komiteti merr vendim për përtëritjen e GP-së për rishikimin e listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve dhe për themelimin e GP-së për Monitorimin dhe Raportimin mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër punës së fëmijëve. Këto dy grupe fuqizohen përmes Vendimit nr. 360 dhe Vendimit nr. 361 të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, datë 2 dhjetor 2011.</p> <p>Të dyja grupet janë funksionale dhe nën mbështetje teknike të ILO-IPEC.</p>	
<p>Rezultati i pritshëm 5: Është përforcuar kapaciteti i institucioneve në nivel qendror dhe lokal për adresimin e PF-së</p>			
<p>Aktivitetet</p>	<p>Institucioni përgjegjës</p>	<p>Zbatimi</p>	<p>Prioritetet për 2013</p>
<p>5.1 Ngritja e kapacitetit të NJPF-së për adresimin e punës së fëmijëve</p>	<p>MPMS</p>	<p>Gjatë periudhës qershor-dhjetor 2011, ILO-IPEC ka angazhuar një konsulent të jashtëm për mbështetje të Zyrtares së Lartë për Punë të Fëmijëve në MPMS-ë. Gjatë kësaj periudhe është punuar në qartësimin e pozitës dhe obligimeve të zyrtares për PF-në si pikë koordinuese e Qeverisë në adresimin e Punës së Fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe ZPF-ja është mbështetur edhe në realizimin e punëtorive me të gjitha</p>	

		<p>Komitetet Lokale të Veprimit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve, në përgatitjen e Doracakut për zhvillimin e proceseve të MPF-së në komuna si dhe në finalizimin e shablloneve (formave) përkatëse për monitorimin e proceseve për adresimin e punës së fëmijëve në nivel komunal dhe në nivel qendror.</p> <p>ZPF--ja në MPMS-ë vazhdon të mbështetet nga ILO-IPEC në realizimin sa më efektiv të obligimeve të saj.</p>	
<p>5.2 Ngritja e kapaciteteve të Njësive për të Drejtat e Njeriut në nivel qendror dhe komunal mbi punën e fëmijëve</p>	ZKM MAPL	<p>Në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës i cili i dedikohet “Avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë”, ku përfitues kryesorë është ZQM/ZKM, është duke u realizuar Trajnimi për Trajnerë për të Drejtat e Njeriut. Përgjatë trajnimit janë shtjelluar tema që i janë dedikuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Përfitues të trajnimit janë zyrtarët që punojnë në NJDNJ-ë në ministrinë e linjës dhe komuna, si dhe aktorët e tjerë që punojnë për të drejtat e njeriut.</p> <p>Në bashkëpunim me MAPL-në, ILO-IPEC me 22 dhe 26 mars 2012, ka organizuar dy punëtori njëditore me udhëheqësit e NJDNJ-së në komuna, me qëllim të ngritjes së kapacitetit të këtyre njësive për adresimin e punës së fëmijëve, prezantimit të Strategjisë dhe PV-së si dhe procesit të MPF-së në nivel lokal dhe identifikimit të rolit të këtyre njësive në zbatimin e PV-</p>	

		<p>së dhe procesit të MPF-së në nivel komunal.</p> <p>Më 26 dhe 27 prill 2012 është organizuar edhe një punëtori e veçantë dyditore me zyrtarët për DF-në në komuna, me qëllim të ngritjes së kapacitetit të tyre për adresimin e punës së fëmijëve. Në vazhdimësi të kësaj punëtorie, ZDF-të në komuna kanë ndërmarrë disa iniciativa për sensibilizimin e opinionit të gjerë mbi PF-në në komunat në të cilat ata/o veprojnë.</p>	
5.3 Fuqizimi i kapaciteteve komunale në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare	MAPL	<p>Në prill të vitit 2012, MPMS-ja me mbështetje të KE-së ka përfunduar zhvillimin e standardeve minimale për shërbime sociale për pesë kategori të grupeve të marginalizuara, përfshirë fëmijët në punë. Korniza e shërbimeve dhe standardet minimale të shërbimeve sociale për fëmijët në punë, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimin e shërbimeve sociale për fëmijët në punë; - Grupet me prioritet - kriteret për shfrytëzimin e shërbimeve; - Parimet e shërbimeve të kujdesit ditor; <p>Standardet minimale (strukturore dhe funksionale);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mekanizmat për vlerësimin e përmbushjes së standardeve minimale. 	<p>Ngritja e kapacitetit në Drejtoratet Komunale të Shëndetësisë mbi rolin e punëtorëve shëndetësor në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijëve, MSH;</p> <p>Ngritja e kapaciteteve profesionale të ofruesit e shërbimeve sociale në implementimin e standardeve minimale të kujdesit për fëmijët në punët e rrezikshme, MPMS;</p> <p>Ngritja e kapaciteteve në institucionet arsimore në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijët, MASHT.</p>
5.4 Ngritja e kapacitetit të njësisë të PK-së për adresimin e FKPF-së	MPB, PK	<p>Në bashkëpunim me PK-në, ILO-IPEC me 19 dhe 20 qershor 2012 ka organizuar dy punëtori njëditore me 43 zyrtarë policorë për të diskutuar situatën e punës së fëmijëve në Kosovë, rolin e policisë në bashkësi, në mbrojtjen e fëmijëve nga puna si dhe rolin e tyre si pjesë e</p>	

		<p>strukturave komunale për monitorimin e punës së fëmijëve.</p> <p>Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë ka hartuar Urdhrin Operativ “Largimi i personave që kërkojnë lëmshë”. Bazuar në këtë urdhër të gjitha drejtoritë, respektivisht Stacionet Policore kanë hartuar planet operative dhe kanë ndërmarrë veprime konkrete në terren në përputhje me urdhrin operativ, me qëllim largimin nga rruga të personave që kërkojnë lëmshë. Në kuadër të kësaj iniciative, gjatë vitit 2012 PK-ja ka identifikuar 107 fëmijë që kërkojnë lëmshë. Urdhri Operativ vazhdon të implementohet në bashkëpunim me QPS-të, gjykatat dhe OJQ-të.</p>	
5.5 Shtimi i kapacitetit të Trupës së Inspektoratit të Punës (TEIP) në lidhje me FKPF-në	TEIP-MPMS	<p>Në bashkëpunim me TEIP-në, ILO-IPEC ka organizuar dy punëtori dyditore me 44 inspektorë të punës (31 maj-1 qershor 2012, 7 dhe 8 qershor 2012). Qëllimi i punëtorive ishte të diskutohen parimet dhe funksionet e sistemit të inspektimit të punës sipas Konventave të ONP-së, trajtimi i grupeve të cënueshme, situata e punës së fëmijëve në Kosovë, roli i inspektorëve të punës në identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga puna, si dhe roli i tyre si pjesë e strukturave komunale për monitorimin e punës së fëmijëve.</p>	Fuqizimi i rolit të inspektorëve të punës në zbatimin e listës së punëve të rrezikshme të fëmijët, TEIP
5.6 Ngritja e kapacitetit në institucionet e drejtësisë për të mitur mbi FKPF, me fokus në çështjet që kanë të bëjnë me të miturit në konflikt me ligjin.	MD Gjykatat e qarkut Shërbimi korrektues	<p>Gjatë vitit 2012 Shërbimi Korrektues i Kosovës ka organizuar trajnime për të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi për trajnerë të SHSK- 	

		<p>së në programin e përkujdesjes për të miturit që lirohen nga burgu (12 zyrtarë);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi për futjen e të dhënave në databazë për të miturit që janë raste të SHSK-së (të gjithë zyrtarët sprovues 65); - Trajnimi për menaxhimin e rasteve për të miturit me sjellje asociale ose në konflikt me ligjin (2 trajnime x 7 zyrtarë), në kuadër të Task Forcave të themeluara nga Terre des Hommes. - Punëtori në kuadër të Institutit Gjyqësor të Kosovës për zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të mitur (5 punëtori x 10 zyrtarë) 	
Rezultati i pritshëm 6: Partnerët social janë aktivë në adresimin e PF-së			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
6.1 Ngritja e kapacitetit të Këshillit Ekonomik-Social për adresimin e punës së fëmijëve	KES MPMS OEK BSPK AKB KSLK	Kapaciteti i partnerëve social (përfaqësuesve të punëdhënësve dhe të punëtorëve) mbi funksionin e tyre në adresimin e punës së fëmijëve, përfshirë funksionin e tyre në kuadër të KES-it, është ngritur përmes punëtorive të shumta të organizuara nga ILO-IPEC. Në kuadër të draftit të Marrëveshjes Kolektive janë reflektuar edhe çështjet që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve dhe rolin e partnerëve social në këtë drejtim.	Aprovimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive
6.2 Ndërgjegjësimi i organizatave të punëdhënësve dhe punëdhënësve individual të sektorit privat mbi punën e fëmijëve	OEK OEA AKB	Bazuar në konsultime të shumta me organizatat e punëdhënësve dhe punëdhënësit individual, ILO-IPEC në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës ka përgatitur dhe botuar	Mobilizimi i mëtejshëm i punëdhënësve në: a) përfshirjen e punës së fëmijëve në kodet e tyre të etikës, si për aktivitetet e tyre, ashtu edhe për qasje në zinxhirin

		<p>broshurën “Si të parandalohen dhe eliminoen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit” (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze).</p> <p>OEK-u më përkrahje të ILO-IPEC ka realizuar dy projekte me qëllim të informimit të punëdhënësve mbi bazën ligjore sa i përket punësimit dhe punës së fëmijëve në Kosovë, si dhe sensibilizimit të punëdhënësve mbi punën e fëmijëve dhe rolin e tyre në adresimin e punës së fëmijëve, me fokus të veçantë në sektorin e ndërtimitarisë dhe të bujqësisë. Përveç takimeve informative dhe konsultative me mbi 100 anëtarë të saj, OEK-u ka shtypur edhe 150 postera mbi format e ndaluara të punës së fëmijëve në sektorin e bujqësisë, 200 postera dhe 400 fletushka mbi punën e fëmijëve në sektorin e ndërtimitarisë të cilat iu janë shpërndarë anëtarëve të saj.</p> <p>OEK-u, po ashtu në kuadër të kontratave që ka me anëtarët e saj, ka përfshirë një klauzolë me të cilën njofton punëdhënësit me rolin e tyre (joobligativ por të rëndësishëm) në zbatimin e katër parimeve fundamentale të ONP-së (përfshirë adresimin e punës së fëmijëve) dhe parimeve të Global Compact të Kombeve të Bashkuara.</p>	<p>furnizues (sidomos kur në sektorët e tyre ka nënkontraktues në ekonominë joformale),</p> <p>b) pjesëmarrjen financiare në aktivitete sociale që shënjestrojnë eliminimin e punës së fëmijëve, dhe</p> <p>c) ofrimin e mundësive të punësimit familjeve në nevojë.</p>
<p>6.3 Ndërgjegjësimi i sindikatave mbi punën e fëmijëve</p>	<p>BSPK</p>	<p>Bazuar në konsultime të shumta me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ILO-IPEC ka përgatitur dhe botuar broshurën “Si të parandalohen</p>	

		dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë organizatat e punëtorëve” (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze).	
6.4 Fuqizimi i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës për adresimin e PF-së	SBASHK	<p>Gjatë periudhës 2011-2012 SBASHK-u me përkrahje të ILO-IPEC ka realizuar disa iniciativa me qëllim të mobilizimit e shkollave për adresimin e punës së fëmijëve përmes shoqatave të SBASHK-ut në shkolla. Pjesëmarrëse në projekt ishin 9 shkolla të komunave Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren të cilat u angazhuan në identifikimin e 344 fëmijëve të përfshirë në punë, analizën e rreziqeve më të cilat këta fëmijë përballen dhe shkaqeve që i kanë shtyrë për angazhim në punë të fëmijëve si dhe përgatitjen e planeve individuale të shërbimeve për këta fëmijë. Në kuadër të kësaj iniciative janë organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - debate mbi rolin e shkollave në adresimin e punës së fëmijëve me personelin mësimor të 9 shkollave (626 pjesëmarrës); - debate mbi mundësitë reale të shkollave dhe kujdestarëve të klasave dhe të ofruesve tjerë të shërbimeve për adresimin e nevojave të fëmijëve të përfshirë në punë me 233 kujdestar klasash në 9 shkollat e përfshira në projekt; - takime konsultative mbi pasojat e punës së fëmijëve dhe shërbimet në dispozicion për fëmijët dhe familjet e tyre me 243 prindër të fëmijëve të identifikuar në punë; 	<p>Mobilizimi i potencialit të sindikatave për të kontribuar në adresimin e punës së fëmijëve përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) identifikimit dhe denoncimit të punës së fëmijëve në nivel lokal, b) dokumentimit të rasteve konkrete dhe evidentimit të pasojave të punës së fëmijëve, dhe c) sensibilizimit të komunitetit për rëndësinë e arsimit të fëmijëve, mbrojtjes së fëmijëve nga rreziqet dhe parandalimin e përfshirjes së tyre në punë.

		<p>- punëtori trajnuese me 274 nxënës, anëtarë të grupeve për të drejta të fëmijëve në shkolla, mbi rolin e bashkëmoshatarëve në adresimin e punës së fëmijëve;</p> <p>- aktivitete të shumta edukative për fëmijët e identifikuar në punë.</p>	
Rezultati i pritshëm 7: Është përmirësuar cilësia e arsimit për të gjithë fëmijët			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
7.1 Ngritja e cilësisë së arsimit	MASHT DKA	<p>Arsimi fillor dhe i mesëm është përcaktuar nga implementimi i kornizës së re kurrikulare, nga përpjekjet e vazhduara për konsolidimin e vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe institucioneve të këtyre niveleve të arsimit (matura dhe testet e klasave të pesta e të nënta), shkollave me përfundimin e investimeve kapitale të filluara para disa vitesh, vazhdimi i furnizimit të fëmijëve të arsimit të obliguar me tekste shkollore, funksionalizimi i sistemit për mbledhjen e menaxhimin e informatave arsimore e të tjera.</p> <p>Investimet në infrastrukturë kanë ndikuar në përmirësimin e dukshëm të kushteve të punës duke e shtuar hapësirën shkollore dhe duke eliminuar ndërrimin e tretë në pjesën më të madhe të shkollave të Kosovës (Janë ndërtuar 7 godina shkollore dhe vazhdojnë punimet në ndërtimin e 27 objekteve shkollore).</p> <p>Vlerësimi i jashtëm i nxënësve dhe institucioneve</p>	<p>Të shtohen aktivitetet ekstrakurrikulare në shkolla (promovim i listës së formave të rrezikshme të punës së fëmijëve, diskutime, aktivitete artistike, etj.)</p> <p>Të zbatohen në shkolla materialet didaktike (të miratuara nga MASHT-i) dedikuar parandalimit të punës së fëmijëve,</p> <p>Të inkurajohen shkollat në planifikimin e temës kundër punëve të rrezikshme për fëmijë, si lëndë zgjedhore.</p>

		<p>arsimore ka vazhduar të prodhojë informacione të vlefshme për funksionimin e sistemit arsimor. Segmenti që vazhdon të ndihmojë si buxhetin e familjes kosovare ashtu dhe cilësinë e arsimit, mbetet shpërndarja e teksteve falas për nxënësit e arsimit të obligueshëm.</p> <p>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), tani ka radhitur zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe të administratorëve të arsimit në mesin e prioriteteve të veta më madhore, duke u bazuar në praktikat e mira dhe standardet e BE-së për mësimitdhënës. Komponenti i Zhvillimit Profesional të mësimitdhënësve nuk shihet më si proces i izoluar, por i ndërlidhur me aspektet tjera të avancuara të sistemit të licencimit, veçanërisht standardet e mësimitdhënies, vlerësimit të performancës, monitorimin e procesit, akreditimin e programeve dhe ofrueseve të trajnimeve, etj.</p> <p>Janë trajnuar mbi 11,000 mësimitdhënës nga ofertues të ndryshëm në partneritet me MASHT-in. MASHT-i ka financuar programin e AKM-së për ngritjen e kualifikimeve të mësimitdhënësve prej shkollave të larta pedagogjike dyvjeçare në nivelin bachelor (të diplomuar 1000, ndërkaq në vitin 2012/2013 janë në proces të rikualifikimit edhe 1914 mësimitdhënës).</p>	
--	--	---	--

		MASHT-i gjithashtu e ka financuar programin për shkathtësitë në kompjuterë – Licenca Evropiane e Përdorimit të Kompjuterit (ECDL) për 12.743 mësime/mësues. Në procesin e licencimit të mësime/mësuesve kanë aplikuar mbi 19.000 mësime/mësues dhe kanë fituar të drejtën e marrjes së licencave të karrierës. Licencat e para iu janë dhënë 100 mësime/mësuesve.	
7.2 Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim	MASHT DKA	<p>Brenda vitit 2012 janë shënuar të arritura në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, bazuar në vizionin e politikave dhe praktikave arsimore gjithëpërfshirëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 14 shkolla dhe institucione të reja parashkollore gjithëpërfshirëse, në të cilat janë punësuar 14 mësues/edukatorë mbështetës; - Janë hartuar dhe aprovuar 5 udhëzime administrative që dalin nga Ligji për Arsimin Parauniversitar; - Përgatitja e kornizës për komponentët monitorues të qendrave burimore; - Është mbajtur Konferenca dy ditore me Universitetin e Anadollit, ku morën pjesë 65 pjesëmarrës, qëllimi i konferencës ka qenë bashkëpunimi mes MASHT-it dhe Universitetit të Anadollit-Turqi; - Janë trajnuar 573 mësime/mësues dhe edukatorë në programet: Indeksi për gjithëpërfshirje, Plani Individual i Arsimit (PIA), Mësime/mësues në fushatë aktiviteteve, Autizmi; 	

		<ul style="list-style-type: none"> - Mbajtja e Konferencës në bashkëpunim me Shoqatën për të shurdhrit në Kosovë me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Personat që nuk dëgjojnë; - Ka filluar zbatimin e indeksit për gjithëpërfshirje në 7 shkolla; - Mbajtja e punëtorisë “Konsultime me partnerë për përkrahje në implementimin e politikave gjithëpërfshirëse në arsim”; - Përgatitja e dokumentit për mënyrën e themelimit dhe funksionimit të ekipeve vlerësuese në nivel komunal; - trajnimi i 75 mësimdhënësve për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta sipas Planit Individual të Arsimit; - Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Shoqatën Kosovare të të Shurdhëve lidhur me zbatimin e projektit për asistent dhe instruktor të gjuhës së shenjave; - Themelimi i grupit ndërsektorial për dokumentin “Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit KNF” ; - Në kuadër të projektit finlandez janë përfshirë 4 shkolla model ku janë mbajtur kurse për shkrim-lexim, janë hartuar testet për shkrim-lexim dhe janë mbajtur me nxënësit e klasave të 2-3-të. Janë organizuar trajnime me gjithë stafin e shkollave në programet, PIA, programi TESFA, programi për shkrim-lexim etj. 	
7.3 Implementimi i masave parandaluese dhe luftimi i dhunës në shkollë	MASHT DKA	MASHT-i mori pjesë në grupet ndërministrorë për hartimin e dokumenteve tjera,	

		<p>si: Procedurat Standarde të Veprimit për Viktimat e Trafikimit, Plani i Veprimit për Zbatimin Rezolutës 1325, Kornizën e Monitorimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë, rishikimin e Listës së Formave të Rrezikshme të Punës për Fëmijët në Kosovë, procedurat standarde të veprimit kundër dhunës në familje, etj. Të gjitha këto reflektojnë edhe mbi stabilitetin dhe sigurinë në komunitet dhe shkolla. Në kuadër të projekteve promovuese për të drejtat e fëmijës/njeriut, janë realizuar programe të ndryshme, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferenca me nxënës “Të drejtat e mia”, me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve; - 10 punëtori për të drejtat e fëmijëve (me gjithsej 360 nxënës, 14 shkolla të 6 komunave), ku ndër të tjera janë trajtuar edhe puna e fëmijëve, çështjet e trafikimit, dhunës, sigurisë, etj.; - aktivitetet në shënim të muajit antitrafikim 2012, - Projekti me dy shkolla në shënim të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje, etj. <p>Gjithashtu, NJDNJ-ja, e cila merr pjesë në Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë e ka vënë në agjendën e këtij Këshilli, finalizimin dhe zyrtarizimin e Protokollit kundër Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar. Brenda këtij protokollit shihen përgjegjësitë ligjore dhe</p>	
--	--	---	--

		<p>institucionale të secilit brenda shkollës dhe të institucioneve të tjera në relacion me dhunën në shkolla.</p>	
<p>7.4 Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore</p>	<p>MASHT DKA</p>	<p>Edukimi parashkollor publik aktualisht organizohet në 43 institucione parashkollore publike me 5,389 fëmijë të përfshirë, dhe në klasën para-filllore grupmosha 5-6 vjet me 20,317 fëmijë të përfshirë.</p> <p>Gjatë vitit 2012, Ministria e Arsimit në bashkëpunim të ngushtë me donatorët, vëmendje të veçantë i ka kushtuar fushatës së vetëdijesimit për rëndësinë e investimit dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme.</p> <p>U realizua fushata për rëndësinë e investimit në edukim e fëmijërisë së hershme me moton “Ylli yt” prej 1 qershor - 1 shtator 2012, e përcjellë me aktivitete të shumta.</p> <p>Janë hartuar shtatë module të bazuara në fushat zhvillimore të dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjet dhe ka filluar pilotimi i dokumentit, me trajnimin pilot në 4 komuna me edukatorët dhe drejtoreshat e institucioneve parashkollore të të gjitha grupmoshave.</p> <p>Si pjesë e hartimit të dokumentacionit pedagogjik për institucionet parashkollore, ka qenë hartimi i dy ditarëve të rinj, njeri për edukimin parashkollor dhe njëri për klasën para-filllore. Në kuadër të përmirësimit të punës në institucionet parashkollore, krijimit të kushteve për</p>	

		<p>përfshirjen më të madhe në klasën para-fillore, gjatë vitit 2012, MASHT-i ka shpërndarë inventar për mobilimin e 12 klasave para-fillore, dhe iu është ofruar mbështetje me inventar edhe 15 institucioneve parashkollore në bazë të standardeve ndërkombëtare të përcaktuara për këtë grupmoshë.</p> <p>Licencimi i institucioneve parashkollore, ka qenë njëri ndër intervenimet kryesore për vitin 2012, me të cilin sigurohet një përfshirje më e madhe, e sigurt dhe e kontrolluar në institucionet parashkollore. Deri tani për licencë kanë aplikuar 71 institucione parashkollore me një numër prej 1,370 fëmijësh, të përfshirë në këto institucione. Procedura e vlerësimit ka përfunduar për 6 institucione të cilat janë licencuar, ndërkaq procesi i licencimit do të vazhdojë edhe në vitin 2013.</p> <p>Gjatë vitit 2012 janë themeluar dy institucione të reja parashkollore me partneritet publiko-privat, një në komunën e Deçanit dhe një në komunën e Prishtinës. Qendrat me bazë në komunitet kryesisht janë të përkrahura nga donatorët, UNICEF-i ka 4 qendra me bazë në komunitet në komunën e Mitrovicës, Ballkan Sunflowers një qendër në Fushë Kosovë, ndërsa projekti SIMRAES i financuar nga Bashkimi Evropian përkrah 6 qendra që janë në shërbim të komuniteteve RAE.</p>	
--	--	--	--

Rezultati i pritshëm 8: Shoqëria është ndërgjegjësuar për pasojat negative të PF-së			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
8.1 Ndërgjegjësimi i deputeteve të Kuvendit të Kosovës dhe sigurimi i mbështetjes së tyre për ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme ligjore dhe financiare në dobi të aktiviteteve kundër PF-së	KKPEPF MPMS	Doracaku “Udhëzues praktik për parlamentarët nr. 3-2002: Eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve”, është botuar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe është shpërndarë në Parlamentin e Kosovës.	Zbatimi i plotë i aktivitetit 8.1
8.2 Ndërgjegjësimi i deputeteve të kuvendeve komunale dhe sigurimi i mbështetjes së tyre për iniciimin dhe përkrahjen e iniciativave për adresimin e PF-së	MAPL, NJDNJ në komuna	MAPL-ja me mbështetje të ILO-IPEC ka bërë ngritjen e kapacitetit të NJDNJ-së në komuna mbi rolin e asambleve komunale për adresimin e punës së fëmijëve. Njëkohësisht NJDNJ-ve në komuna iu janë shpërndarë Udhëzuesit Praktik për Parlamentarët për Konventën Nr. 182 të ONP-së.	Angazhim i mëtejshëm i NJDNJ-ve në ndërgjegjësimin e parlamentarëve për adresimin e punës së fëmijëve.
8.3 Rritja e ndërgjegjësitimit tek publiku i gjerë mbi punën e fëmijëve dhe intervenimet e nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e FKPF	MAPL MPMS Komunat Asociacioni i OJQ-ve për DF	NJDNJ-MBPZHR në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit Rural dhe Shërbimeve Këshillimore dhe me Zyrat Regjionale të MBPZHR-së, organizuan takime regionale me fermerë, përfitues të subvencioneve dhe granteve të MBPZHR-së. Realizimi i takimeve është mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës - Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC). Takimet e organizuara kishin për qëllim: - Njoftimin e fermerëve me format e rrezikshme të punës së fëmijëve në sektorin e bujqësisë, që kërkojnë ndalim të menjëhershëm, - Vetëdijësimin e fermerëve	Ndërgjegjësimi i mëtejshëm i fermerëve mbi punët e rrezikshme të fëmijëve në bujqësi. Mobilizimi i personaliteteve të njohura të cilët mund të influencojnë opinionin publik.

		<p>mbi rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në këto aktivitete,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diskutimin e shkaqeve për përfshirjen e fëmijëve në aktivitete të rrezikshme bujqësore, dhe - Diskutimin e masave që mund të ndërmerren për të parandaluar angazhimin e fëmijëve në aktivitete të rrezikshme dhe për të tërhequr fëmijët që aktualisht janë të përfshirë në punë të rrezikshme. <p>Në takimet e organizuara morën pjesë 103 fermerë, përfitues të granteve dhe subvencioneve nga MBPZHR-ja, 39 përfaqësues të Drejtorive Komunale të Bujqësisë dhe 17 përfaqësues të Zyrave Regjionale të MBPZHR-së.</p> <p>Në vazhdimësi të fushatës sensibilizuese me fermerë, MBPZHR-ja me mbështetje të ILO-IPEC organizoi një konferencë pune për të diskutuar gjetjet nga takimet me fermerë rreth situatës së punës së fëmijëve në bujqësi dhe pylltari, për të planifikuar masat e nevojshme për adresimin e PRRF-së në bujqësi dhe për të vendosur një platformë të përbashkët të MBPZHR-së me autoritetet komunale përkatëse, organizatat e punëdhënësve, prodhuesit dhe përpunuesit e ushqimit, shoqatat e fermerëve, si dhe partnerët e tjerë për adresimin e punës së fëmijëve.</p> <p>Fushata e Kundër-Trafikimit 2012 u fokusua në</p>	
--	--	---	--

		<p>eksploatin e fëmijëve për qëllime seksuale, për punë dhe lypje. Qëllimi i kësaj ishte rritja e vetëdijes së përgjithshme, por veçmas vetëdijesimin e fëmijëve, prindërve dhe mësimdhënësve lidhur me rrezikun e trafikimit (KNKT, SKT, ZBE/KMOP dhe GPNM).</p> <p>ILO-IPEC ka financuar botimin e SCREAM në gjuhën shqipe dhe në bashkëpunim me MKRS-në ka organizuar një punëtori dyditore me 38 përfaqësues të qendrave rinore dhe OJQ-ve aktive me programe për të rinj dhe fëmijë, me 25 përfaqësues të klubeve të bashkëmoshatarëve në shkolla, si dhe 25 përfaqësues të programit By Youth for Youth (PEN) me qëllim të ngritjes së kapacitetit të tyre për shfrytëzimin e SCREAM dhe identifikimin e mundësive për shfrytëzim të kësaj pakoje edukative në aktivitetet e përditshme të qendrave rinore.</p>	
<p>8.4 Ndërgjegjësimi dhe implementimi i aktiviteteve avokuese tek mjetet e informimit publik mbi intervenimet e nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së</p>	<p>MPMS, Bashkimi i Gazetarëve Profesionist të Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave, Komisioni për të DNJ-në</p>	<p>I parealizuar</p>	<p>Sensibilizimi dhe mobilizimi i mjeteve të informimit publik</p>

Objektivi specifik II			
Zbatimi i ndërhyrjeve të menjëhershme për parandalimin e përfshirjes së fëmijëve të rrezikuar dhe tërheqjen e fëmijëve të përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve			
Rezultati i pritshëm 1: Janë eliminuar barrierat e qasjes në arsim dhe janë në dispozicion programet e edukimit jo-formal			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për vitin 2013
1.1 Hartimi dhe zbatimi i një programi pilot që mundëson identifikimin dhe eliminimin e barrierave që ndërlihen me koston e edukimit	Komunat, DKA, MASHT	Asociacioni i Komunave të Kosovës respektivisht Kolegjiumi për Arsim dhe Kulturë me mbështetje të Zyrës Ndërkombëtare të Punës - Programit për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC) dhe në bashkëpunim me MASHT-in organizoi punëtorinë dy ditore “Arsimi dhe puna e fëmijëve”. Punëtorja kishte për qëllim inicimin e diskutimeve mbi nivelin e përfshirjes së aspekteve specifike që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve në politikat dhe programet arsimore dhe shqyrtimin e mundësive për përfshirje më të plotë të shqetësimeve që lidhen me punën e fëmijëve në planet dhe programet sektoriale të arsimit. Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues nga MASHT-i, përfaqësues nga Instituti i Politikave Sociale-MPMS, përfaqësues të Drejtorateve Komunale të Arsimit, përfaqësues të DKSHMS-ve, përfaqësues të QPS-ve, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Arsimit (SBASHK), organizatave jo qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare. Konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga punëtorja ofrojnë një bazë të mirë për hartimin e një	Monitorimi i zbatimit të U.A. Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar; Mbështetja e DKA-ve në zhvillimin dhe aplikimin e planeve për eliminimin e barrierave në arsim për fëmijët e përfshirë në punë.

		programi pilot për eliminimin e barrierave në arsim.	
1.2 Ofrimi i programeve të mësimit të përshpejtuar për rikthim në shkollë të fëmijëve të përfshirë në FKFP, që kanë braktisur shkollën	MASHT Komunat DKA Shkollat	<p>Të dhënat e viteve të fundit tregojnë një rënie të numrit të fëmijëve që braktisin shkollën, edhe pse shifrat ekzistuese janë për brengosje. Rënia e numrit të braktisjes nëpër vite konsiderohet të jetë rezultat i përpjekjeve të mëdha të MASHT-it me partnerët e vet, për ta trajtuar këtë problem me efikasitet. (Shih tabelën e prezantuar në raportin narrativ.)</p> <p>Plani i veprimit kundër braktisjes së shkollës më tej u integrua edhe në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, që do të thotë aspektet e parandalimit të braktisjes janë preokupim i vazhdueshëm i MASHT-it. MASHT-i dhe GIZ-ja kanë vazhduar me kurse kompensuese të arsimit joformal, ashtu që nëpërmjet arsimit joformal, nxënësit braktisës mund të riintegrohen në sistem të rregullt.</p> <p>Aktivitetet e MASHT-it që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve dhe shkollave për menaxhimin e të dhënave të arsim janë duke ndodhur në vazhdimësi. Këtu përpunohen në vazhdimësi edhe të dhënat statistikore për braktisje.</p>	
1.3 Ofrimi i programeve të edukimit joformal në zona të caktuara për të mbështetur ri-integrimin në shkollë të fëmijëve që e kanë braktisur atë dhe/ose	MASHT MKRS Komunat	MASHT-i ka hartuar dhe shpërndarë në drejtoritë komunale të arsimit, UA Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (i hartuar dhe	

<p>përmirësimin e performancës së fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën</p>		<p>miratuar në fund të 2011); Ka shumë aktivitete të planit që janë kompetencë e komunave dhe shkollave, të cilat janë në zbatim e sipër (transporti i nx., listat e nx. të klasave të para, grumbullimi i të dhënave për braktisje etj.);</p> <p>MASHT-i me ndihmën e UNICEF-it dhe donatorëve të tjerë, po realizon projektin “Forcimi i komuniteteve RAE në Fushë Kosovë”, i cili ka për qëllim të përmirësojë vijueshmërinë e fëmijëve RAE në arsim dhe performancën e tyre në mësimnxënie. Në kuadër të këtij projekti fëmijët marrin ndihmë në këtë drejtim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukimi parashkollor- përgatit fëmijët për klasën e parë (70 fëmijë, 3 seanca të përditshme). - Ndhima për detyrat e shtëpisë iu mundëson fëmijëve për të mbajtur vazhdimësinë e mësimëve dhe të zhvillojnë shprehitë e punës/ mësimin (200 fëmijë, 5 seanca). - Klubi i gjuhës iu jep fëmijëve shkrim-lexim, ashtu që u shtohet atyre besimi në gjuhën që ata shkollohen. - 20 vullnetarë/ tutorë kontribuojnë çdo ditë në qendrën e Fushë Kosovës. Po ashtu, punohet në fuqizimin e nënave dhe motrave më të mëdha që ato t'i ndihmojnë fëmijët e tyre, por ka edhe aktivitete për të inkurajuar nënat që të vijnë në shkollë. 	
<p>1.4 Zhvillimi i profileve të veçanta për aftësim profesional në përputhje me kërkesat e tregut në regjionet përkatëse</p>	<p>MASHT</p>	<p>Gjatë vitit 2012 MASHT-i ka vazhduar hartimin e kurrikulave për profile të ndryshme, furnizimin e shkollave me punëtori e pajisje, ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese e të</p>	

		<p>tjera, që kanë kontribuar për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në këtë nënsektor. Si rezultat mund të veçojmë hartimin e standardeve të profesionit dhe kurrikulat për 6 profile të reja të sektorit të bujqësisë, një për qeramikë dhe 21 për sektorin e shëndetësisë, ekonomisë dhe turizmit.</p> <p>Aktualisht arsimi profesional është i organizuar në 61 shkolla nga gjithsej 108 shkolla të mesme, ku dy prej tyre janë Qendra të Kompetencës, ndërsa mësimi zhvillohet në disa profile, që përfshin 55.8 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë.</p> <p>Janë intensifikuar takimet në mes të MASHT-it, MPMS-së, MT-së, OEK-ut dhe partnereve tjerë ku janë identifikuar analizat ekzistuese të tregut të punës, janë rifunksionalizuar nëngrupet sektoriale për AAP-në, si dhe është themeluar wiki-platforma ku janë regjistruar të gjitha shkollat profesionale dhe është planifikuar që të lidhen me një link me MPMS-në dhe OEK-un, dhe të kenë qasje në analiza të tregut të punës dhe të dhënat e bizneseve.</p>	
Rezultati i pritshëm 2: Janë në dispozicion shërbimet e tërheqjes dhe ri-integrimit afatgjatë të fëmijëve			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritet për 2013
2.1 Pilotimi i një pakoje të shërbimeve cilësore elementare për tërheqjen dhe ri-integrimit e fëmijëve të përfshirë në FRRP në bujqësi	MAPL DKSHMS MPMS MBPZHR QPS OJQ	Me iniciativë të MBPZHR-së dhe DKSHMS-së në Komunën e Rahovecit dhe me mbështetje të ILO-IPEC, OJQ RDSA është duke zbatuar një projekt për pilotimin e një pakoje të shërbimeve elementare për tërheqjen dhe ri-integrimit e	Vazhdimi i intervenimeve për eliminimin e punëve të rënda në bujqësi dhe pylltari.

		fëmijëve të përfshirë në FRRPF-së në bujqësi, në fshatrat Bratotin dhe Vrajakë të komunës së Rahovecit. Projekti financohet nga FDC (Finnish Development Cooperation) dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet komunale të Komunës së Rahovecit, të cilat kanë siguruar gjithë mbështetjen e nevojshme institucionale. Raporti me arritjet e projektit, mësimet e nxëna dhe vazhdimësinë e nevojshme për adresimin efektiv të punës së rrezikshme të fëmijëve në sektorin e bujqësisë pritet të jetë në dispozicion në fund të projektit (tetor 2013).	
2.2 Pilotimi i një pakoje të shërbimeve cilësore elementare për tërheqjen e fëmijëve të përfshirë në FRRP në rrugë përfshirë, ndihmë të menjëhershme dhe integrim afatgjatë	MAPL DKSHMS MPMS QPS OJQ	I porealizuar	Zbatimi i aktivitetit ose shfrytëzimi i rekomandimeve të ILO-IPEC (QMVPT) të dala nga pilotimi i intervenimeve për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve në rrugë gjatë periudhës 2007-2009.
2.3 Pilotimi i një pakoje të shërbimeve cilësore elementare për tërheqjen e fëmijëve të shfrytëzuar për aktivitete në konflikt me ligjin, përfshirë ndihmë të menjëhershme dhe integrim afatgjatë	MD MPB QPS OJQ	I porealizuar	Zbatimi i aktivitetit ose shfrytëzimi i rekomandimeve të UNICEF-it (Terre des Hommes), të dala nga pilotimi i intervenimeve për tërheqjen dhe ri-integrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.

2.4 Sigurimi i shërbimeve për mbështetje psiko-sociale për fëmijën dhe familjen	MSh, DKSHMS	Në qendrat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore nuk ekzistojnë mbështetje të këtilla për familjen dhe fëmijën e përfshirë në punë të rënda.	Shqyrtimi i mundësive për sigurimin e këtyre shërbimeve, në ato institucione që është e mundur.
Rezultati i pritshëm 3: Janë funksionalizuar programe për fuqizimin ekonomik të familjeve të fëmijëve të rrezikuar apo të përfshirë në FKPF			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
3.2 Zbatimi i projekteve pilot për gjenerimin e të ardhurave për familjet e fëmijëve të rrezikuar apo të përfshirë në FKPF, në zonat gjeografike me rrezikshmëri të lartë	MBPZHR, Drejtoratet Komunale për Bujqësi, MPMS, ZPPQPS, OJQ	I parealizuar	Përfshirja e shqetësimeve që lidhen me punën e fëmijëve në programet për fuqizim ekonomik (programet për gjenerimin e të hyrave, programet e punësimit, programet për zhvillimin e bujqësisë, etj.);
Rezultati i pritshëm 4: Sistemi i MPF-së shtrihet në tërë Kosovën			
Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Zbatimi	Prioritetet për 2013
4.1 Zbatimi i Planit të Veprimit për shtrirjen e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve	MPMS, Komunat	IPS-MPMS në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe me mbështetjen e ILO-IPEC, gjatë vitit 2011 ka bërë arritje të konsiderueshme në ngritjen dhe përgatitjen e strukturave të Monitorimit të Punës së Fëmijëve në komuna, përmes punëtorive treditore të realizuara me të gjitha KLV-të, si dhe përgatitjes dhe botimit të “Udhëzuesit për zhvillimin e procesit të MPF-së në komuna”, në gjuhën shqipe dhe serbe. Përveç komunikimit të vazhdueshëm me koordinatoret e KLV-ve dhe disa punëtorive të organizuara me koordinatoret, në fund të vitit 2012, IPS-MPMS me mbështetje të ILO-IPEC realizoi edhe 12 punëtori njëditore me 245 anëtarë të Komiteteve Lokale të Veprimit	Angazhim i mëtejshëm i MPMS-së për institucionalizimin dhe funksionalizimin e plotë të KLV-ve në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe MAPL-në.

		<p>në të gjitha komunat e Kosovës¹. Qëllimi i punëtorive ishte diskutimi i zhvillimeve në konsolidimin e MPF-së në komuna, sfidat dhe zgjidhjet e mundshme. Një raport përmbledhës me situatën e përgjithshme të KLV-ve në komuna (problemet e përgjithshme me të cilat ato përballen), rekomandimet për funksionalizimin e KLV-ve dhe prioritetet për vitin 2013 është përgatitur dhe është ndarë me të gjitha KLV-të. Në dhjetor të vitit 2012 është organizuar takimi ifundit me koordinatorët e KLV-ve.</p> <p>Mbështetja dhe mbikëqyrja institucionale e KLV-ve në komuna vazhdon të jetë e dobët.</p>	
<p>4.2 Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe funksionalizimi i Komiteteve Lokale te Veprimit në të gjitha komunat</p>	<p>Komunat MPMS</p>	<p>Në vazhdimësi të punëtorive të fundit të organizuara nga IPS-MPMS me KLV-të në komuna dhe mbështetjes së ofruar në kompletimin e procedurave, rregulloreve dhe formave të nevojshme, progres i konsiderueshëm është evidentuar në disa komuna, përfshirë:</p> <p>-Gjakovën, Kaçanikun, Hanin e Elezit, Dragashin, Vushtrrinë, Lipjanin dhe Podujevën ku janë zyrtarizuar procedurat standarde të veprimit, rregullorja e punës së KLV-së dhe forma për evidentimin e rasteve, si dhe</p>	

¹ Komunat të cilat nuk iu përgjigjën ftesës për punëtori janë Kllokoti, Juniku dhe Ranillugu; në komunat me shumicë serbe punëtoritë nuk janë organizuar pasi që atje ende nuk janë themeluar KLV-të.

		<p>janë hartuar planet komunale të veprimit për adresimin e PF-së;</p> <p>- Rahovecin, ku janë finalizuar procedurat standarde të veprimit, rregullorja e punës së KLV-së dhe plani i punës për vitin 2013, por ende nuk janë zyrtarizuar;</p> <p>- Dardanën, ku është hartuar dhe miratuar nga Asambleja Komunale plani komunal i veprimit për vitin 2013.</p>	
<p>4.3 Themelimi i qendrave të kujdesit ditor dhe strehimit të përkohshëm të fëmijëve të tërhequr nga situatat e FRRP me rrezikshmëri shumë të lartë</p>	<p>MPMS Komunat</p>	<p>Katër qendra ditore për ofrim të shërbimeve ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e dhunës në familje, apo raste të tjera të fëmijëve në nevojë (përfshirë fëmijët e përfshirë në punë), janë themeluar në Peje, Prizren, Gjilan e Ferizaj, me mbështetje të KE-së.</p>	